

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 6 paragrafi 13 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 20.03.2011, Rregullorën QRK Nr. 13/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës është miratuar në mbledhjen e 195 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr. 02/195 me datë 03.09.2014, miratoi këtë:

STATUT

TË QENDRËS SË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i Statutit të Qendrës së Studentëve (më tutje QS) të Universitetit të Prishtinës, është që të rregulloj ofrimin e shërbimeve për studentët e UP-së, si: strehimin, ushqimin, përkujdesjen mjekësore, shërbimet e jetës kulturore, sportive dhe zbavitëse për student.
2. Mënyrën e funksionalizimit, qeverisjes dhe menagjimit të QS.

1. Dispozitat e përgjithshme

Neni 2 Themelimi

Qendra e studentëve e Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejme (Qendra e Studentëve), është themeluar në bazë të Vendimit të Këshillit Ekzekutiv të KSAK nr. IV – 3444, dt. 20.07.1960.

Neni 3 Emërtimi

1. Emri i Qendrës së Studentëve në gjuhën shqipe është: “Qendra e Studentëve e Universitetit të Prishtinës në Prishtinë”.
2. Emri i Qendrës së Studentëve në gjuhën angleze është: “Students Centre University Of Prishtina”.
3. Emri në gjuhën serbe është: “Studentski centar Univerziteta u Pristini”.

Neni 4 **Selia**

Selia e Qendrës së Studentëve është në këtë adresë: rruga ‘‘Agim Ramadani’’p.nr. 10.000. Prishtinë.

Neni 5 **Statusi i Qendrës së Studentëve**

Qendra e Studentëve është institucion publik jofitimprurës me cilësi të personit juridik, me të drejta dhe detyrat e përcaktuara në këtë statut dhe me ligjet në fuqi duke përfshirë të drejtën për të paditur dhe për tu paditur.

Neni 6 **Shfrytëzimi dhe menagjimi i pronave**

Shfrytëzimi dhe menagjimi i pronave dhe ndertesave bëhet në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 7 **Simbolet**

1. Qendra e Studentëve ka keto simbole:
 - 1.1 Stemën dhe
 - 1.2 Flamurin
2. Simbolet e Qendrës së Studentëve të UP propozohen nga Drejtori i Qendrës së Studentëve dhe miratohen nga Ministri i MASHT-it.

Neni 8 **Vulat**

1. Qendra e Studentëve ka vulen e rumbullakët, vulen katërkëndëshe dhe vulat tjera zyrtare.
2. Format dhe dimensionet e vulave:
 - 2.1 Vula e rumbullakët e Qendrës së Studentëve me dimensione 28 mm.
 - 2.2 Vula katërkëndëshe me dimensione 55mm X 23mm.
3. Vulat tjera zyrtare:
 - 3.1 Numri, forma, dimensionet dhe përmbajtja e vulave tjera zyrtare përcaktohet me vendim të veçantë të Ministrit të MASHT me propozim të drejtorit të përgjithshëm të QS.

4. Përdorimi dhe ruajtja e të gjitha vulave do të rregullohet me aktet nenligjore të nxjerra nga Drejtori i Qendrës së Studentëve.

2. Dispozitat e Veçanta

Neni 9

Të drejtat dhe përgjegjësitë:

1. Qendra e Studentëve ka drejtat dhe përgjegjësitë:
 - 1.1. Të veproj në ofrimin e shërbimeve cilësore për studentë,
 - 1.2 Të ndihmoj në procesin e promovimit të demokracisë qytetare,
 - 1.3 Të synoj krijimin dhe mbështetjen e standardëve me të larta në fushën e përgjegjësisë të Qendrës së Studentëve,
 - 1.4 Të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efektive,
 - 1.5 T'u përshtatët standardeve evropiane,
 - 1.6 Të zhvilloj dhe zbatoj strategjitë e ofruara nga MASHT-i;
 - 1.7 Propozimin dhe pranimin e tarifave,
 - 1.8 Punësimi dhe shkarkimi e personelit për shkaqe ligjore;
 - 1.9 Nënshkrimin e kontratave për mallra dhe shërbime;
 - 1.10. Vendosjen për përmbajtjen dhe strukturën e programeve punuese, artistike dhe profesionale,
 - 1.11 Vendosjen e marrëdhënieve juridike me studentët dhe përcaktimin kushtëve për strehimin e studentëve,
 - 1.12. Aplikimi i masave të duhura për vlerësim dhe sigurim të cilësisë së shërbimeve,
 - 1.13. Nënshkrimim e marrëveshjeve me bartësit vendor dhe ndërkombëtar, brenda përgjegjësisë të përcaktuara në Qendrën e Studentëve,
 - 1.14. detyrat e tjera të nevojshme për kryerjen e funksionit të Qendrës së Studentëve në pajtim me këtë statut,
 - 1.15. të rregulloj strukturat dhe aktivitetet e saj përmes rregullave të qendres së Studentëve në përputhje me ligjet në fuqi dhe aktet tjera të nxjerra nga këto ligje, bazuar në dispozitat e këtij statuti,
 - 1.16. të zgjedhë personelin e Qendrës, të përcaktoj kushtet për pranimin e studentëve përfitues nga shërbimet e ofruara nga Qendra e Studentëve,
 - 1.17. të zhvilloj dhe zbatojë planprogramet dhe projektet e punës në pajtim me këtë statut dhe me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Shërbimet në Qendrën e Studentëve

1. 1. Qendra e Studentëve ofron këto shërbime:

- 1.1 Konvikte për studentë,
- 1.2 Mensë për studentë,
- 1.3 Paisje dhe objekte për rekreacionin e studentëve,
- 1.4 Paisje dhe objekte për kulture dhe argëtim të studentëve,
- 1.5 Shërbime dhe përkujdesje mjeksore për studentë.

Neni 11

Struktura Organizative

1. Qendra e Studentëve përbehet nga kjo Strukturë Organizative:

- 1.1. Zyra e drejtorit të përgjithshëm
- 1.2. Drejtoratet;
- 1.3. Sektorët.

2. Drejtorit udhëhiqen nga drejtorët e tyre.

3. Struktura Organizative e QS të UP përcaktohet me Rregullorën QRK Nr. 13/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës është miratuar në mbledhjen e 195 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr.02/195 me datë 03.09.2014.

Neni 12

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka përgjegjësi për:

- 1.1. Miratimin e planit dhe programit të punës të Qendrës së Studentëve,
- 1.2. Miratimin e raportit vjetor të punës në QS,
- 1.3. Miratimin e planit vjetor financiar të QS,
- 1.4. Miratimin e raportit vjetor financiar të QS,
- 1.5. Miratimin e planit afatmesëm dhe afatgjatë zhvillimor të QS;
- 1.6. Miratimin për kushtet dhe kriteret e pranimi të Studentëve në Konvikte dhe Menzën e Studentëve, të propozuara nga Drejtori i QS.
- 1.7. Miraton projektet tjera me interes për QS.

Neni 13

Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve

1. Drejtori i përgjithshëm është nëpunës civil, i zgjedhur dhe emëruar në pajtim legjislacionin në fuqi dhe i nënshtrohet zbatimit të legjislacionit në fuqi të shërbimit civil të Republikës së Kosovës.
2. Drejtori, krahas detyrave të përcaktuara me ligj, kryen edhe këto punë:
 - 2.1. Udhëheq dhe përfaqëson Qendrën e Studentëve dhe kujdeset për ligjshmërinë e veprimtarisë dhe të organeve të saj;
 - 2.2. Është urdhërues dhe përgjegjës për zbatimin e planit financiar të dhe planit të punës të Qendrës e Studentëve;
 - 2.3. Shpall konkurset për vendet e punës dhe përkujdeset për zhvillimin e procedurave sipas ligjit;
 - 2.4. Nënshkruan kontratat e punës dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen procedurale sipas ligjit dhe këtij statuti;
 - 2.5. Nënshkruan dokumentet e Qendrës të cilat kanë karakter të akteve të veçanta;
 - 2.6. Nënshkruan kontrata me palën e tretë në bazë të kompetencave të tij;
 - 2.7. Siguron zbatimin e mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes nga zjarri;
 - 2.8. Nxjerr akte nënligjore në përputhje me këtë Statut dhe ligjet përkatëse;
 - 2.9. Vendos mbi nevojën për furnizim të Qendrës së Studentëve me mjete themelore dhe inventar për aq sa e ka të lejuar me kompetenca;
 - 2.10. Drejtori i Qendrës së Studentëve për punën e vet i raporton dhe i përgjigjet Ministrit të MASHT-it dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT-it, në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe të ligjit.
 - 2.11. Raporton në baza tre mujore me shkrim dhe sipas nevojës te Ministri i MASHT për çështje të detyrave dhe përgjegjësive ligjore të Qendrës së Studentëve dhe në baza mujore te Sekretari i Përgjithshëm për çështje të natyrës operationale.
 - 2.10. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara nga MASHT në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 14

Marrëdhënia e punës së drejtorit të Qendrës së Studentëve

1. Marrëdhënia e punës së drejtorit të Qendrës së Studentëve i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për shërbimin civil dhe aktet tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 15 **Financimi**

1. Qendra e Studentëve financohet nga këto burime;

- 1.1. Nga buxheti i MASHT-it;
 - 1.2. Nga të hyrat vetanake;
 - 1.3. Donacionet e ndryshme;
 - 1.4. Nga burime tjera ligjore;
2. Të hyrat vetanake të Ënedrës së Studentëve janë;
 - 2.1. Pagesat nga strehimi i studentëve;
 - 2.2. Pagesat e ushqimit;
 - 2.3. Pagesat nga qiraja;
 - 2.4. Pagesat nga Palestra e sportive;
 - 2.5. Burime tjera ligjore.

Neni 16 **Menaxhimi financiar**

1. Menagjimi i buxhetit në Qendrën e Studentëve bëhet nga drejtori i përgjithshëm duke respektuar kufijtë e kompetencave në raport me MASHT-in, në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligjin për MFP dhe aktet tjera ligjore që rregullojnë këtë fushë.
2. Projektet kapitale që kanë vlerën zbatuese mbi 20.000 euro duhet të miratohen paraprakisht nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it.
3. Realizimi i mjeteve vetanake rregullohet me akt të veçantë të propozuar nga Qendra e Studentëve e të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it dhe Ministria e Financave.

Neni 17 **Ruajtja dhe mbajtja e dokumentacionit financiar**

1. Qendra e studentëve duhet të mbajë dokumentacionin përkatës financiar mbi të hyrat vetanake si dhe mënyrën e shpenzimeve të tyre, në përputhje me ligjet me aktet tjera nënligjore të kësaj fushe.
2. Mbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit financiar është përgjegjësi e drejtorit të drejtorisë për buxhet dhe financa në Qendrën e Studentëve.
3. Mbikëqyrjen e mbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit financiar, e bën drejtori i përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.
4. Drejtorja e prokurimit të Qendrës së Studentëve është i obliguar që të udhëheq të gjitha procedurat e prokurimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
5. Rishikimi i buxhetit të Qendrës së Studentëve bëhet çdo gjashtë muaj.
6. Mbykëqyrja financiare bëhet nga auditori i MASHT-it dhe ai i përgjithshëm.

3.Dispozitat Kalimtare

Neni 18 Dispozitat Kalimtare

1. Që nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, Drejtori i Përgjithshëm i QS, obligohet që brenda 3 muajve të bëjë harmonizimin e akteve tjera nënligjore me këtë Statut.
2. Zyrtarët kryesor: drejtori i përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe personeli tjetër udhëheqës si dhe të gjithë punëtorët tjerë marrëdhëniet e punës e rregullojnë në pajtim me këtë Statut, Ligjin mbi Shërbimin Civil dhe Ligjin e Punës.
3. Të gjitha programet e punës që janë duke u zbatuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti konsiderohen të aprovuara.

4.Dispozitat Shfuqizuese


Neni 19 Dispozitat Shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i Qendrës së Studentëve nr.115/01B, I DATËS 14. 05. 2012.

Neni 20 Hyrja në Fuqi

Statuti miratohet dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Prof. Dr. Arsim BAJRAMI


Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

